

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E ENJTE 13 TETOR 2022

Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2022 është qartazi kundër projektit të amnistisë fiskale që po përgatitet nga qeveria. “Miratimi i një amnistie tatimore dhe penale kundër këshillave të BE-së cenon luftën kundër pastrimit të parave”, deklarohet në këtë raport. I njëjti paralajmërim është dhënë për projektin tjetër të qeverisë për skemat e nënshtetësisë për gjoja investitorët e huaj: “Për sa i përket shtetësisë, Shqipëria duhet të frenohet nga zhvillimi i një skeme për nënshtetësinë e investitorëve, pasi do të përbënte rrezik për sa u përket sigurisë, pastrimit të parave, evazionit fiskal, financimit të terrorizmit, korrupsionit dhe infiltrimit nga krimi i organizuar dhe do të ishte i papajtueshëm me kriteret e BE-së”.

Besoj se këto deklarata janë fort të qarta për të gjithë. Por është pikërisht ky hap që qeveria duhet ta kryejë, patjetër për të njëjtat arsye që Komisioni Europian i thekson si rrezik potencial. Me bekimin e institucioneve dhe agjencive qeveritare janë lejuar qëllimisht të zhvillohen një numër i madh biznesesh në vend, të cilat punojnë me para nën dore dhe të paformalizuara. Ndodh në sytë e të gjithëve që kompani, të cilat kanë pronarë në kërkim ndërkombëtar apo në burg për trafik të paligjshëm, të përfitojnë nga tenderët publikë apo PPP-të, duke vënë me shpatulla pas murit kompanitë që konkurrojnë denjësisht apo investitorët e huaj që besojnë te ligji dhe procedurat e drejta.

Të gjithë ekspertët më të njohur të ekonomisë e theksojnë me forcë, si reagim ndaj projekteve të zeza të qeverisë, se asnjë vend në botë nuk zhvillohet mbi bazën e parave kriminale të drogës dhe trafikeve. Ne sot kemi pa dyshim një qeverisje që është kokë e këmbë në mbrojtje të interesave kriminale dhe korruptive në përmasat më dramatike të njohura ndonjëherë. Nga ana tjetër, përpëlitja në këto skema të zeza nxjerr para të gjitha institucioneve ndërkombëtare dhe opinionit publik gjendjen ku është katandisur arka e shtetit, e zhytur në borxhe dhe e degraduar nga pagesat e projekteve korruptive, sikurse telenovela e turpit të bosëve të inceneratorëve.

Së fundi, për shkak të rritjes së interesave të borxhit publik, Banka e Shqipërisë ka shtrënguar politikat monetare, gjë që detyrimisht çon në kredi më të shtrenjta për qytetarët dhe për bizneset. Kjo është një faturë tjetër e keqqeverisjes. Të nderuar qytetarë, disa ditë më parë nga Praga Kryeministri cinik e arrogant iu përgjigjej medieve të huaja se ai nuk kishte përgjegjësi për shqiptarët që po iknin çdo ditë nga vendlindja drejt Francës dhe Britanisë së Madhe, ndërkohë që ai qeveris Shqipërinë. Kjo është e rëndë dhe e papranueshme, pasi asnjë president dhe kryeministër në botë nuk do të bënte një deklaratë të tillë për shtetasit e vet, për çdo qytetar e familjar, gra e fëmijë me pasaportë shqiptare që ikin sikur të ishte vendi në luftë, që rrezikojnë jetën brigjeve të Francës dhe Britanisë dhe përgjegjësia, pa asnjë diskutim, është e kësaj qeverisjeje.

Nga ky parlament u drejtohem sot të gjithë atyre që po emigrojnë, në veçanti bashkëqytetarëve të mi shkodranë, të cilët ndodhen në kampet e Britanisë së Madhe apo janë duke shkuar në Francë apo atyre që ndoshta në këto momente ndodhen në mes të detit: ju, qytetarë të nderuar të Shqipërisë, meritoni të gjithë respektin, sepse jeni shuplaka dhe protesta më e dhimbshme ndaj harbutërisë dhe makutërisë së kësaj qeverie. Ju jeni sot revolta më e fuqishme ndaj korrupsionit, krimit, papunësisë, padrejtësisë dhe shkeljes së dinjitetit njerëzor.